



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:219382
Datë: 05.04.2024
Numri i dokumentit: 05553540

CP.nr.1046/2021

GJYKATA THEMELORE MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, me gjyqtarin Genc Hasani dhe me bashkëpunëtoren profesionale Valbona Tahiri, në lëndën përmbartimore të kreditorit S. H., V. H., N. H., Sh. Sh. M., Q. H. Gj., K.S., I. S., Xh. S., B. H. N. B., te cilët i përfaqëson me autorizim avokat Valdrin Islami, me seli ne Mitrovice, ndaj debitorit Komuna e Mitrovicës – Drejtoria e Arsimit - Mitrovicë, lidhur me pagesën e borxhit ne baze te dokumentit përmbartimor - Aktgjykimi C.nr. 530/2019, te datës 04.06.2021, të lejuar me aktvendimin për përmbartim CP 1046/21, te datës 01.09.2021, jashtë seance gjyqësore, me datën 05.04.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDOHET procedura përmbartimore e udhëhequr sipas shenjës CP 1046/21, me kreditor S. H., V. H., N. H., Sh. Sh. M., Q. H. Gj., K.S., I. S., Xh. S., B. H. N. B., ndaj debitorit Komuna e Mitrovicës – Drejtoria e Arsimit - Mitrovicë, për shkak të pagesës së tërësishme të borxhit nga debitori.

A r s y e t i m

Kreditori i përmbartimit S. H., V. H., N. H., Sh. Sh. M., Q. H. Gj., K.S., I. S., Xh. S., B. H. N. B., te cilin e përfaqëson me autorizim avokat Valdrin Islami me seli ne Mitrovice, ndaj debitorit Komuna e Mitrovicës – Drejtoria e Arsimit - Mitrovicë, ka paraqitur propozim për përmbartim në bazë të dokumentit përmbartimor - Aktgjykimi C.nr. 530/2019, te datës 04.06.2021.

Gjykata Themelore në Mitrovicë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit të përmbartimit, me aktvendimin CP 1046/21, te datës 01.09.2021, ka lejuar përmbartimin ndaj debitorit Komuna e Mitrovicës – Drejtoria e Arsimit – Mitrovicë.

Pasi aktvendimi për ekzekutim CP 1046/21, te datës 01.09.2021, është bere i ekzekutueshëm, kreditori nëpërmes përfaqësuesit me autorizim me dt. ..., ka njoftuar gjykatën se debitori i përmbartimit e ka përmbushur në tërësi borxhin.

Andaj, borxhi i kërkuar sipas propozimit për përmbarim është përmbushur në tërësi, pasi që debitori ka përmbushur në tërësi obligimin ndaj kreditorit të përmbarimit, gjykata duke u bazuar në nenin 66 paragrafi 4 të LPP-së, në të cilin parashihet se “*Pas përmbushjes se kredisë se kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbarimore*”, vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
CP.nr.1046/2021 më datë 05.04.2024

Gjyqtari
Genc Hasani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa brenda afatit 7 ditorë nga dita e pranimit të të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Mitrovicë.